

Nr. 12 Prot.,

Date 18/04/2025

Drejtuar: QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT (QKB)

Nga: Shoqeria "FIER THERMOELECTRIC" Sh.a.

Lenda: Kerkese per azhurnimin e vleres se shlyer te Kapitalit te Shoqerise "FIER THERMOELECTRIC" Sh.a.

Te nderuar,

Shoqeria "FIER THERMOELECTRIC" Sh.a. person juridik shqiptar, me NIPT Nr. M22211019U, dhe seli ne Njesine Bashkiake Nr.1, Rruga "Papa Gjon Pali II- te", Ndertesa Nr.12, Aba Business Center Kati i 7-te, nr. pasurie 7/52-N9, ZK 8160, vol 36, faq 212, Tirane, Shqiperi, ju drejtohet me kete kerkese per azhurnim te te dhenave ne regjistrin tregtar lidhur me kapitalin e shlyer te shoqerise.

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve, date 28.03.2025, eshte miratuar rritja e kapitalit aksionar te shoqerise ne vleren prej **49,480,000 leke**, e cila eshte mbuluar teresisht me mjete monetare nga aksionaret ekzistues, ne perputhje me perqindjet e tyre perkatese ne kapital, si me poshte:

- GEK TERNA SA, ne vleren 17,318,000 leke (kapitali total pas rritjes: 31,201,730 leke);
- GENER2 sh.p.k., ne vleren 14,844,000 leke (kapitali total pas rritjes: 26,744,340 leke);
- DEPA COMMERCIAL SA, ne vleren 17,318,000 leke (kapitali total pas rritjes: 31,201,730 leke).

Ne perputhje me kete vendim, eshte perditesuar edhe neni 7 i Statutit te Shoqerise, ku kapitali aksionar i shoqerise pas rritjes pasqyrohet ne shumen totale prej **89,147,800 leke**.

Referuar ekstraktit aktual te shoqerise, ne date 14.04.2025, eshte regjistruar vendimi per rritjen e kapitalit, dhe bashkengjitur kesaj kerkese gjendet dokumentacioni perkates qe verteton shlyerjen e kapitalit nga secili aksionar nepermjet transfertave bankare.

Duke qene se te gjitha aksionaret kane kryer shlyerjen e kapitalit, referuar edhe dokumentit bashkelidhur, ju kerkojme qe te behet azhurnimi i regjistrit tregtar te Shoqerise "FIER THERMOELECTRIC" Sh.a., duke reflektuar ne piken 9 te ekstraktit vleren reale te kapitalit te shlyer, 89,147,800 leke, dhe te hiqet nga regjistri vlere e meparshme.

Duke ju falenderuar per bashkepunimi

Shoqeria "FIER THERMOELECTRIC" Sh.a.
Vasil Nasti